



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 151 Dt. 12.03.2023
PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Biloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së, Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore (Edicioni 2022/2023), Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim në FBK, si dhe në bazë të Ankesës së KB Sigal Prishtina të datës 11.03.2023, dhe Ankesës së KB Vëllaznimi të datës 11.03.2023, Komisioni Arbitrar i FBK-së, me datë 12.03.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 11.03.2023;
- II. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 11.03.2023;
- III. APROVOHET Ankesa e KB Sigal Prishtina e datës 11.03.2023 si e bazuar;
- IV. REFUZHET Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 11.03.2023 si e pabazuar;
- V. ANULOHET Vendimi Nr.15/2023 i Komisionit të Garave i datës 10.03.2023;
- VI. MBETET NË FUQI Vendimi Nr.13/2023 i Komisionit të Garave i datës 01.03.2023;
- VII. URDHËROHET Federata e Basketbollit të Kosovës të zbatojë këtë vendim.

ARSYETIM

Me datë 11.03.2023, Komisioni Arbitrar, përmes postës elektronike, ka pranuar Ankesën e KB Sigal Prishtina të datës 11.03.2023 (tash e tutje: "Ankesa e KB Sigal Prishtina") dhe Ankesën e KB Vëllaznimit të datës 11.03.2023 (tash e tutje: "Ankesa e KB Vëllaznimi"), konform nenit 43 të Propozicioneve të Garave të FBK-së. Të dy ankesat sfidojnë të njëjtin vendim, Vendimin Nr.15/2023 të Komisionit të Garave të FBK-së të datës 10.03.2023 (tash e tutje: "Vendimi Nr.15/2023"), me ç'rast Komisioni Arbitrar ka vlerësuar si adekuat shqyrtimin e të dy ankesave njëkohësisht.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviç
10 000 Prishtina

Në këtë kuadër, dhe brenda afatit përkatës, Komisioni Arbitrar ka mbajtur takim më 12.03.2023, dhe ka trajtuar Ankesën e KB Sigal Prishtina dhe Ankesën e KB Vëllaznimit. Në takim kanë qenë prezent: Korab Sejdiu (Kryetar i Komisionit Arbitrar), Lulzim Fushtica (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Fidan Hamiti (Anëtar i Komisionit Arbitrar), Elvira Dushku (Sekretare e Përgjithshme e FBK-së) dhe Enea Hajdari (Këshilltare Ligjore për Sport e FBK-së).

Sa i përket Vendimit Nr.15/2023 të shkallës së parë, në pikën 1 Komisioni i Garave miraton ankesën e KB Vëllaznimit, në pikën 2 vendos që ndeshja e xhiros së XXIV-të në mes KB Vëllaznimit dhe KB Sigal Prishtina të zhvillohet sërish, dhe në pikën 3 revokon Vendimin Nr. 13/2023, gjegjësisht vendos të çregjistrojë lojtarin Rezart Memed për sezonin 2022/23.

Sipas kuptimit të Komisionit Arbitrar, KB Sigal Prishtina sfidon në tërësi vendimin Nr.15/2023, dhe konsideron se ka të drejtë të plotë në atë që ka kërkuar dhe i është aprovuar fillimisht, e që në asnjë rrethanë parashtruesi i kërkesës nuk mund të bartë pasoja juridike negative nëse organi kompetent pranon kërkesën e tij, pavarësisht nëse një aprovim i tillë ka qenë lëshim nga ana e organit përkatës. Ndërkaq, Ankesa e KB Vëllaznimit sfidon pikën 2 të Vendimit Nr.15/2023, dhe konsideron se vendimi për përsëritje të lojës nuk qëndron konform akteve normative të FBK-së dhe kërkon që t'i akordohet KB Vëllaznimit fitore me rezultat zyrtar.

Lidhur me ankesën e KB Sigal Prishtina, Komisioni Arbitrar ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Komisioni Arbitrar vlerëson se Vendimi Nr.15/2023 i Komisionit të Garave, me anulimin e Vendimit Nr.13/2023 (pika 3 e Vendimit Nr.15/2023), del jashtë objektit të shqyrtimit. Kjo, sepse asnjëra nga ankesat e klubeve nuk kanë sfiduar Vendimin Nr. 13/2023, dhe të gjitha afatet ankimore për të sfiduar vendimin në fjalë në kohën kur është nxjerrë kanë skaduar pa ndonjë ankesë nga ndonjë palë me interes.

Veç kësaj, Komisioni Arbitrar thekson rëndësinë e parimit të sigurisë juridike. Në rastet si ky, ku vendimet e organeve të FBK-së prodhojnë efekte juridike, e drejta që fitohet nga ato nuk mund të anulohet më vonë sepse cenon sigurinë juridike, e aq më tepër ku një gjë e tillë dëmton mbarëvajtjen e garave të organizuara nga FBK dhe reputacionin e vet institucionit. Njëheri, edhe lëshimet eventuale të organeve të FBK në vendimmarrje, pavarësisht a teknike apo përmbajtësore, të cilat i akordojnë një klubi të drejta të caktuara, nuk mund të përmirësohen më vonë duke ia faturuar atij klubi pasojat eventuale. Aq më tepër, kur një klub i tillë mund të ketë ndërmarr edhe veprime të tjera duke u bazuar në vendimin e organeve të FBK.

Për më shumë, Komisioni Arbitrar ka pasur për bazë edhe paqartësinë juridike të krijuar nga neni 31, alineja 1.1 të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK, me anë të cilit çdo skuadër ka të drejtën e paraqitjes për regjistrim të "vetëm 1 (një) lojtari të natyralizuar nga FBK." Më këtë rast, Komisioni rekomandon organin gjegjës të FBK-së të qartësojë dhe saktësojë dispozitat rreth statusit të lojtarëve/eve të natyralizuar/a, e nëse është e nevojshme, edhe të veçojë natyralizimin "nga FBK" prej rasteve të tjera të natyralizimit të lojtarëve/eve me kërkesa të klubeve.

Lidhur me ankesën e KB Vëllaznimi, Komisioni Arbitrar ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim. Përkitazi me ankesën e KB Vëllaznimi, Komisioni Arbitrar, duke kuptuar plotësisht shqetësimin e ngritur nga klubi, vlerëson se lëshimet e çfarëdo natyre nga ana e organeve të FBK-së nuk duhet t'i faturohen dhe penalizojnë klubet të cilat kanë fituar një të drejtë të caktuar nga ato vendime. Rrjedhimisht, Komisioni Arbitrar e ka të pamundur të aprovojë ankesën e KB Vëllaznimi për arsyet e shtjelluara më sipër, gjegjësisht në arsyetimin lidhur me ankesën e KB Sigal Prishtina.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



TEB

Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOSARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Faza 2
Str: Radovan Zogoviq
10 000 Prishtina

Rrjedhimisht, Komisioni Arbitrar, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Arbitrar:

Fidan Hamiti
Anëtar

Korab Sejdiu
Kryetar

Lulzim Fushtica

Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 12 Mars 2023

Vendimi i dërgohet:

- KB Sigal Prishtina
- KB Vëllaznimi
- Komisionit të Garave
- Anëtarëve të Komisionit Arbitrar
- Arkivit të FBK-së



KËSHILLË JURIDIKE:

Vendimet e arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Sipas Nenit 12 të Rregullores për Punën e Komisionit Arbitrar të FBK-së Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit Arbitrar kanë të drejtë të ankesës te Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

